

Rezultate nga Hulumtimi për jetën kulturore në
KOMUNËN E PRIZRENIT



Përgatitur nga:



Teatri ODA
2010 -2011 Prishtinë

1878

Ekipi i cili mori pjesë ne procesin e Hulumtimit:

- ◆ Florent Mehmeti – Teatri ODA Prishtinë
- ◆ Dukagjin Kelmendi – Teatri ODA Prishtinë
 - ◆ Valmira Thaqi – Teatri ODA Prishtinë
 - ◆ OJQ “Ec ma ndryshe” - Prizren
- ◆ Urim Ukimeri – Koordinator i sektorit të kulturës, Prizren
 - ◆ Bulëza Xhaferi – Prishtinë

Raporti mbi rezultatet hulumtimit është pjesë e Projektit “Kulturë për/nga të gjithë” i realizuar në Partneritet me Qendrën për arte skenike “Multimedia” nga Shkupi, ndërsa i financuar nga Programi Zviceran për Kulturë për Ballkanin Perëndimorë dhe Olof Palme - Qendra Ndërkombëtare.



This brochure has been produced with financial support from The Swedish International Development Cooperation Agency (Sida). Sida is not liable for content, layout or opinions expressed in this brochure

PRIZREN

Partner Lokal: Komuna e Prizrenit dhe OJQ “Ec ma ndryshe”.

PËRMBAJTJA

Parathënie	4
Politikat Kulturore Lokale	5
Kultura dhe zhvillimi	5
Projekti “Kulturë për/nga të gjithë”	6
Metodologjia e punës lidhur me hulumtimin dhe analizën e jetës kulturore në Komunën e Novobërdës.	7
Rezultatet nga hulumtimi	8
1. Rezultatet nga Pyetësorët me Qytetar	8
2. Rezultatet nga Intervistat e orientuara	19
3. Rezultatet nga takimet me fokus grupe	28
Konkludime nga Hulumtimi në Komunën e Novobërdës	32



Falënderim

Teatri ODA singërisht falënderon Komunën e Prizrenit, Kryetarin e Komunës së Prizrenit Z. Ramadan Muja, ekipin e ti, e në veçanti Koordinatorin e sektorit për kulturë Z. Urim Ukimeri të cilët e kuptuan rëndësinë e Projektit dhe tërësisht përkrahën zbatimin e ti. Në të njëjtën kohë Teatri ODA falënderon edhe ekipin lokal të udhëhequr nga Z. Valon Xhabali nga OJQ “Ec ma ndryshe” të cilët ndihmuan në procesin e hulumtimit pranë kësaj komune.

Teatri ODA falënderon edhe anëtarët e Rrjetit rinor të Prizrenit, artistët dhe aktivistët në sferën e kulturës të cilët kanë kontribuar me pjesëmarrjen dhe idetë e tyre në realizimin e hulumtimit në Komunën e Prizrenit. Falënderime speciale Teatri ODA i drejton të gjithë qytetarëve të Prizrenit të cilët përmes përgjigjeve të tyre në pyetësor na ndihmuan të kemi informata kualitative mbi jetën kulturore në këtë komunë.

Në fund, por jo nga rëndësia, ky Projekt nuk do të mund të realizohej pa përkrahjen financiare të Programit Zviceran për Kulturë dhe Qendrës Ndërkombëtare Olof Palme.

PARATHËNIE

Qëllimi i përpilimit të këtij raporti mbi rezultatet e hulumtimit në komunën e Prizrenit është që në mënyrë konkrete të na njoftoj me jetën kulturore në këtë Komunë dhe përmes përcaktimit të situatës aktuale të ndihmoj në procesin e planifikimit të strategjisë për zhvillimin e kulturës.

Të ju përkujtojmë se fjala kulturë rrjedhë nga fjala latine “colere” që d.m.th. “të kultivojmë” dhe njëri ndër definicionet e sajë është “kompleks i përbashkët i sjelljeve, vlerave, qëllimeve dhe praktikave të cilat karakterizojnë një institucion, organizatë apo grup të caktuar” prandaj ajo shihet si “një mënyrë e veçantë të cilën njerëzit që jetojnë në anë të ndryshme të botës e përdorin për të prezantuar në mënyrë karakteristike dhe me kreativitet eksperiencat e tyre”.

Kultura prezantohet përmes artit, literaturës, traditës dhe sjelljeve të anëtarëve të një shoqërie dhe vlerat kulturore i japin identitetin një shoqërie.

Pra, në këtë aspekt qëllimi i projektit tonë është të ndihmojmë komunat që të planifikojnë strategji të cilat do të kultivonin me tutje vlerat e qytetarëve të tyre.

Për të planifikuar këtë strategji fillimisht na është nevojitur përkrahja nga strukturat komunale të Prizrenit, dhe më pas si hapë i dytë në arritjen e këtij qëllimi na janë nevojitur informatat lidhur me situatën aktuale të kulturës në këtë komunë prandaj edhe i shohim si shumë të rëndësishme rezultatet e mbledhura nga procesi i hulumtimit.

Është synim i të gjithë përfituesve nga ky projekt që deri në fund të vitit 2011 të finalizohet strategjia për zhvillimin e kulturës në komunën e Prizrenit dhe të fillohet me zbatimin e sajë.

Hulumtimi u realizua në Komunën e Prizrenit në periudhën Qershor – Dhjetor 2010 nga OJQ ODA, me përkrahje të vazhdueshme nga Z. Urim Ukimeri, koordinator i sektorit për kulturë dhe Z. Valon Xhabalit nga OJQ “Ec ma ndryshe”.

Në hulumtimin janë përfshirë Kryetari i Komunës së Prizrenit, përfaqësues të strukturave komunale, përfaqësues të organizatës Rrjeti Rinor, artistët e sferave të ndryshme kulturore si dhe 450 qytetarë të cilët jetojnë në këtë komunë. Ky hulumtim është pjesë e Projektit tre vjeçar “Kulturë për/nga të gjithë” në të cilin përveç Novobërdës, Gjilanit dhe Prizrenit, si përfaqësues të Republikës së Kosovës, marrin pjesë edhe tri komuna nga Maqedonia.

Me respekt,
OJQ ODA

POLITIKAT KULTURORE LOKALE

Kultura duhet të jetë një forcë dinamike, sfiduese dhe e pavarur e bazuar në lirin e të shprehurit. Të gjithë qytetarët duhet të kenë mundësin për pjesëmarrje në jetën kulturore. Kreativiteti, diversiteti dhe kualiteti artistik duhet të jenë pjesë integrale e zhvillimit të shoqërisë.

Shoqërisë i nevojitet një jetë e fortë kulturore. Përmes potencialeve të saj duhet të lëviz dhe inspiroj, kultura kontribuon në dy drejtime, në fuqizimin individual dhe zhvillimin e shoqërisë në tërësi. Arti duhet lejuar të zhvillohet në mënyrën e vetë dhe duhet pasur hapësirë për perspektiva të reja në trashëgimin kulturore.

Për të arritur këto objektiva, politikat kulturore duhet të:

- ◆ Promovojnë mundësin që të gjithë ta shijojnë kulturën, marrin pjesë në programe edukative dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre kreative;
- ◆ Promovojnë kualitetin dhe rinovimin artistik;
- ◆ Promovojnë dinamikën e trashëgimisë së ruajtur, asaj që shfrytëzohet dhe asaj që do të krijohet;
- ◆ Promovojë shkëmbimet kulturore në nivel ndërkombëtarë dhe ndërkulturor si dhe kooperimin në sferën e kulturës;
- ◆ T'i kushtojë vëmendje të veçantë të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve për kulturë.

Shoqëria duhet të karakterizohet dhe identifikohet nga pasuria e shprehjeve artistike të cilat i posedon, pa marr parasysh fushën në të cilën ato janë shfaqur.

KULTURA DHE ZHVILLIMI

Kultura në shumë vende të Evropës dhe botës konsiderohet si forcë shtytëse e zhvillimit social dhe ekonomik. Në vitet e fundit interesimi për industritë kulturore si fuqi ekonomike është ngritur dukshëm. Komisioni Evropian ka identifikuar kulturën dhe sektorët e sajë si fuqia kryesore ekonomike dhe sociale në Evropë. Ekziston një dallim i vogël apo nuk ekziston fare dallimi nëse konsiderohen të ardhurat që sjellin qytetet e mëdha industriale në krahasim me të ardhurat që sjellin qytetet e mëdha kulturore.

Specifikat kulturore të qyteteve bëhen tullë në ndërtimin e statusit të tyre ekonomik dhe një element i cili shtynë komunitetin e biznesit të tërheq resurset, njerëzit dhe kapitalin.

PROJEKTI “KULTURË PËR/NGA TË GJITHË”

Projekt kooperativ i politikave kulturore mes Kosovës dhe Maqedonisë

Projekti bazohet në supozimin se kultura nuk është një opsion shtesë për Komunitet e Kosovës dhe Maqedonisë, por është një komponent esenciale për unitetin e tyre social, për përmirësimin e kualitetit të jetës së qytetarëve të tyre pa marrë parasysh prapavijën e tyre etnike, fetare, edukative apo sociale apo kontributin e tyre në zhvillimin ekonomik.

Nëse kultura ka të bëjë me identitetin, stilin jetësor, sjelljen, etikën, qeverisjen dhe mënyrat me të cilat ne kalojmë përditshmërinë tonë, atëherë kjo nuk do të duhej të jetë e vështirë për tu pranuar. Nëse pajtohemi të kemi politika për kulturën apo të lidhim kulturën me veprimet të cilat do të shpëtojnë deri te zhvillimi atëherë ne po ashtu po pranojmë, në mënyrë të përcaktuar apo sugjeruese, logjikën e planifikimit. Planifikimi prandaj nuk ka të bëjë vetëm me “infrastrukturën e rënd” por po ashtu me infrastrukturën e butë dhe kreative: me nevojat dhe vizionin e qytetarëve.

Projekti ka për qëllim të sigurojë progres në jetën kulturore në 6 komuna të Kosovës dhe Maqedonisë duke zhvilluar infrastrukturën e nevojshme politike, dhe integrimin e atyre politikave brenda komunave në të dy vendet.

Duke e bërë këtë, Projekti do të ndërtojë kapacitetet e grupeve të ndryshme nga komunitet e zgjedhura, do të provokojë produktivitetin dhe bashkëpunimin e artistëve; do të ndaj përvojat e mësuara në mes të komunave dhe të palëve të tjera në regjion dhe BE, dhe në fund do të:

- ◆ Lehtësojë dhe inkurajojë pjesëmarrjen e qytetarëve në krijimin e politikave dhe marrjen e vendimeve në nivelin lokal;
- ◆ Identifikojë dhe zhvillojë sistemin e instrumenteve në fushën e kulturës e cila do të shpinte te zhvillimi sistematik kulturor i Komunave;
- ◆ Zgjerojë kapacitetet e artistëve dhe operatorëve kulturor për të influencuar më shumë në proceset e krijimit të politikave kulturore në nivelin lokal dhe nacional në të dy vendet dhe të nxis një qasje të dukshme kritike ndaj proceseve shoqërore.;
- ◆ Përmirësojë bashkëpunimin regjional ne mes të komunave nga të dy vendet e përfshira në Projekt përmes shkëmbimit të veprave artistike, njohurive dhe eksperiencave të fituara gjatë procesit të përbashkët tre vjeçar.

Zgjedhja e Komunave

Gjatë zgjedhjes se komunave OJQ ODA ka përdorur një varietet të kriterëve, duke u nisur nga struktura shumë etnike e banorëve të tyre, zhvillimi i tyre ekonomik dhe social, madhësia dhe ofertat kulturore. Po fillojmë radhazi, Prizreni është qyteti i dytë për nga madhësia në Kosovë, një qytet shumë etnik relativisht i zhvilluar ekonomikisht, me një histori dhe trashëgimi kulturore shumë të pasur për kushtet Kosovare, Gjilani në anën tjetër është qytet i mesëm, po ashtu ka karakter shumë etnik, dikur i zhvilluar ekonomikisht dhe një qendër në të

cilën ka resurse njerëzore për zhvillimin e aktiviteteve kulturore, kurse Novobërda është një qytet shumë etnik, i vogël por shumë i lashtë, i pazhvilluar ekonomikisht i cili rishtas ka fituar statusin e komunës.

METODOLOGJIA E PUNËS LIDHUR ME HULUMTIMIN DHE ANALIZËN E JETËS KULTURORE NË KOMUNËN E PRIZRENIT.

Metodologjia e punës gjatë realizimit të aktiviteteve; hulumtimi dhe analiza e jetës kulturore në komunën e Prizrenit është bazuar në mbledhjen e të dhënave nga burime të ndryshme dhe analizimi i tyre kuantitativ dhe kualitativ. Rezultatet e dala nga ky hulumtim duhet të shërbejnë për krijimin e strategjisë së zhvillimit kulturor në komunën e Prizrenit.

Metodat të cilat janë përdorur në këtë hulumtim janë si në vijim:

1. Puna në teren

- ◆ Intervista me përfaqësuesit e strukturave të qeverisjes komunale (analiza kualitative e përgjigjeve gjatë intervistave)
- ◆ Pyetësorët dedikuar qytetarëve të Komunës së Prizrenit (analizë kuantitative e të dhënave)
- ◆ Takimet me fokus grupe – debate mbi situatën kulturore (analizë kualitative dhe kuantitative e të dhënave)

2. Puna në zyrë – analiza kualitative e të dhënave të mbledhura.

- ◆ Intervista me përfaqësuesit e strukturave të qeverisjes komunale (analiza kualitative e përgjigjeve gjatë intervistave)

Intervistat me përfaqësuesit e qeverisjes lokale në komunën e Prizrenit janë bërë me qëllim që të mbledhim informata mbi mendimet, qëndrimet dhe vizionin e qeveritarëve komunal lidhur me kulturën dhe zhvillimin e sajë. Pyetjet e formuluar nga ekipi i OJQ ODA fokusohen në:

- Informata mbi komunën
- Mendimet për kulturën dhe zhvillimin e sajë
- Sektorin e Shoqërisë civile
- Minoritetet
- Media
- Sektori i biznesit

- ◆ Pyetësorët dedikuar qytetarëve të Komunës së Prizrenit (analizë kuantitative e të dhënave)

Pyetësorët për qytetarë janë përpiluar nga ekipi i OJQ ODA në bashkëpunim me partnerët nga PAC Multimedia dhe qëllimi i tyre është që sa më shumë të mblidhen informata rezultat e të cilave do të na tregojnë situatën kulturore në komunën e Prizrenit, përfshirë ofertën kulturore dhe më e rëndësishmja propozimet e qytetarëve për zhvillimin kulturorë. Përpunimi i të dhënave është bërë me program të avancuar statistikor dhe rezultatet do të prezantohen në vijim të këtij raporti.

- ◆ Takimet me fokus grupe – debate mbi situatën kulturore (analizë kualitative dhe kuantitative e të dhënave).

Qëllimi i takimeve me fokus grupe ishte që me grupe të caktuara të interesit të debatohet mbi zhvillimin e kulturës në komunë, duke u përqendruar në problemet aktuale, mendimet për zgjedhjen e tyre dhe propozimet për zhvillimin kulturor. Përzgjedhja e fokus grupeve në këtë komunë është bërë duke përdorur kriterin e funksionimit të grupit, apo duke marr parasysh sa janë aktive këto grupe në këtë komunë.


REZULTATET NGA HULUMTIMI

1. Rezultatet nga Pyetësorët me Qytetar

Pyetësorët janë përpiluar nga OJQ ODA duke i kushtuar vëmendje të veçantë gjinisë, moshës, përkatësisë etnike, statusit martesor, statusit social dhe nivelit të arsimit. Hulumtimi është realizuar gjatë periudhës Qershor – Nëntor 2010 dhe për realizmin e ti janë përfshirë aktivistët e OJQ “Ec ma ndryshe” të cilët paraprakisht u trajnuan dhe udhëzuan. Kriter për vlefshmërinë e pyetësorit ishte që të plotësohen të gjitha rubrikat kurse numri i qytetarëve të cilët plotësuan pyetësorët ishte 450, nga këto vetëm 1 ishte i pavlefshëm (u zëvendësua pasi që kishte 5 pyetësor të plotësuar më shumë) pasi që nuk ishin plotësuar të gjitha rubrikat.

Në vijim po i prezantojmë rezultatet:


Gjinia



Gjinia:

■ Në Prizren nga 450 qytetarë,
229 apo 50.9 % ishin Meshkuj
kurse
221 apo 49.1 % ishin Femra.


Mosha



Mosha:

Mosha e të
anketuarve ishte:
18 deri 27
- 240 persona apo 53.3%
28 deri 37
- 87 persona apo 19.3 %
38 deri 47
- 80 persona apo 17.8 %
Mbi 48
- 43 persona apo 9.6 %


Arsimi



Niveli Arsimor:

■ Përgatitja arsimore e të
anketuarve ishte:
■ Fillore: 75 persona apo 16.7 %
■ Mesëm: 228 persona apo 50.7 %
■ Lartë: 147 persona apo 32.7 %


Nacionaliteti



Përkatësia etnike:

Shqiptar:
380 persona apo 84.4 %
Të tjerë:
70 persona apo 15.6 %

Statusi Social




Statusi Social:

Të punësuar:
190 persona apo 42.2 %

Të papunësuar:
260 persona apo 57.8 %

Statusi Martesor




Statusi Martesor:

Të martuar
203 persona apo 45.1 %

Të pamartuar
247 persona apo 54.9 %

1. Në vijim qytetarët janë pyetur për vizitat që ata i bëjnë ngjarjeve të ndryshme kulturore dhe numrit të tyre:


Muzika Klasike - Sa here ne 12 muaj



a) Për numrin e ndjekjes së Koncerteve të Muzikës Klasike:

Asnjëherë: 319 persona apo 70.9 %
 1 deri 5 herë: 121 persona apo 26.9 %
 5 deri 10 herë: 6 persona 1.3 %
 10 deri 20 herë: 2 persona 0.4 %
 Më shumë se 20 herë: 2 persona apo 0.4 %


Jazz.muzika



b) Për numrin e ndjekjes së koncerteve të Muzikës Jazz:

Asnjëherë:
323 persona apo 71.8 %
 1 deri 5 herë:
111 persona apo 24.7 %
 6 deri 10 herë:
15 persona apo 3.3 %
 11 deri 20 herë:
1 person apo 0.2 %
 Më shumë se 20 herë:
0 persona apo 0.0 %


Teater



c) Përcjellja e shfaqjeve teatrore:

Asnjëherë:
170 persona apo 37.8 %
1 deri 5 herë:
220 persona apo 48.9 %
6 deri 10 herë:
50 persona apo 11.1 %
11 deri 20 herë:
7 persona apo 1.6 %
Më shumë se 20 herë:
3 persona apo 0.7 %


Pop muzika



e) Përcjellja e koncerteve të muzikës Pop (zbavitëse):

Asnjëherë:
188 persona apo 41.8 %
1 deri 5 herë:
121 persona apo 26.9 %
6 deri 10 herë:
76 persona apo 16.9 %
11 deri 20 herë:
39 persona apo 8.7 %
Më shumë se 20 herë:
26 persona apo 5.8 %


Muzika.folklorike



d) Përcjellja e koncerteve të muzikës folklorike:

Asnjëherë:
152 persona apo 33.8 %
1 deri 5 herë:
183 persona apo 40.7 %
6 deri 10 herë:
82 persona apo 18.2 %
11 deri 20 herë:
26 persona apo 5.8 %
Më shumë se 20 herë:
7 persona apo 1.6 %


Kinema



f) Vizita kinemave:

Asnjëherë:
162 persona apo 36.0 %
1 deri 5 herë:
198 persona apo 44.0 %
6 deri 10 herë:
68 persona apo 15.1 %
11 deri 20 herë:
16 persona apo 3.6 %
Më shumë se 20 herë:
6 persona apo 1.3 %


Techno Party



g) Pjesëmarrje në "Techno Party":

Asnjëherë:
212 persona apo 47.1 %
1 deri 5 herë:
95 persona apo 21.1 %
6 deri 10 herë:
69 persona apo 15.3 %
11 deri 20 herë:
48 persona apo 10.7 %
Më shumë se 20 herë:
26 persona apo 5.8 %


Vizita Muzeut



h) Vizita muzeve, galerive apo ekspozitave:

Asnjëherë:
186 persona apo 41.3 %
1 deri 5 herë:
196 persona apo 43.6 %
6 deri 10 herë:
54 persona apo 12.0 %
11 deri 20 herë:
10 persona apo 2.2 %
Më shumë se 20 herë:
4 persona apo 0.9 %

Balet, Opera, Filharmoni




i) Përcjellja e baletit, operës, Filarmonisë:

Asnjëherë:
361 persona apo 80.2 %
1 deri 5 herë:
74 persona apo 16.4 %
6 deri 10 herë:
13 persona apo 2.9 %
11 deri 20 herë:
1 person apo 0.2 %
Më shumë se 20 herë:
1 person apo 0.2 %

2. Në pyetjen se sa shpesh i vizitojnë ngjarjet kulturore jashtë komunës së tyre, përgjigjet ishin si në vijim:

Vizita ngjarjeve kulturore jashte komunës




Vetëm në Komunën time:
366 persona apo 81.3 %

Më shumë jashtë komunës
sime:
66 persona apo 14.7 %

Vetëm jashtë komunës
sime:
4.0 persona apo 4.0 %

3. Na interesonte të dimë se sa kanë qytetarët njohuri për institucionet (monumentet) në komunën e tyre, dhe me këtë rast përgjigjet ishin:

A i dini institucionet kulturore që ekzistojnë



Nuk di për ndonjë:
101 persona apo 22.4 %


Nuk më kujtohen:
18 persona apo 4.0 %

Po, di për këto:
331 persona apo 73.6 %

Nga qytetarët të cilët kanë pasur njohuri për Institucione (monumente) është kërkuar të përmendin konkretisht institucionin apo monumentin, dhe mund të thuhet se në 100 % të rasteve kanë përmendur Kalanë, Teatrin, kurse në disa raste janë përmendur edhe Kinemaja dhe Biblioteka.

4. Kur i keni vizituar ato monumente?:


Kur per here te fundit i vizituar institucionet



Kurrë nuk i kam vizituar ato:
16 persona apo 3.6 %
Para më pak se një muaji:
140 persona apo 31.1 %
Para 3 deri 6 muajve: 129
persona apo 28.7 %
Para 1 viti: 129 persona apo
28.7 %
Nuk di: 36 persona apo 8.0
%

5. Në pyetjen mbi njohuritë e qytetarëve për monumentet kulturo historike të komunës së tyre:

A dini per monumente Kulturo-historike



Nuk di: 12 persona apo 2.7 %


Nuk më kujtohet: 29 persona
apo 6.4 %

Po: 409 persona apo 90.9 %

Edhe në këtë rast qytetarët të cilët kishin njohuri për monumente në të shumtën e rasteve kanë përmendur Kalanë , kurse kishte shumë raste kur përmendej edhe Shtëpia e Lidhjes së Prizrenit, Hamami, Objektet fetare, etj.


6. Kur i keni vizituar këto monumente kulturore-historike?:

Per here te fundit vizituar monumentet




Para 1 muaji: 98 persona apo 21.8 %
 Para 3 deri 6 muajve: 166 persona apo 36.9 %
 Para më shumë se 1 viti: 160 persona apo 35.6 %
 Nuk më kujtohet/asnjëherë: 26 persona apo 5.8 %

7. Ku janë mbajtur aktivitetet kulturore në Prizren?




Shtëpi të Kulturës: 263 persona apo 58.4 %
 Qendër kulturore: 53 persona apo 11.8 %
 Teatro: 40 persona apo 8.9 %
 Vende të Pavarura/OJQ: 7 persona apo 1.6 %
 Kinema: 14 persona apo 3.1 %
 Hallë e sportit: 47 persona apo 10.4 %
 Muze: 2 persona apo 0.4 %
 Vende të hapura: 15 person apo 3.3 %
 Diskotekë: 2 persona apo 0.4 %
 Nuk e di: 7 persona apo 1.6 %

8. Sa jeni të kënaqur me shfaqjet teatrale që i prodhon teatri i Prizrenit:




Aspak i/e kënaqur: 131 persona apo 29.1 %
 Jo i/e kënaqur sa duhet: 156 persona apo 34.7 %
 Mesatarisht: 112 persona apo 24.9 %
 Mjaft i kënaqur: 39 persona apo 8.7 %
 Shkëlqyeshëm: 12 persona apo 2.7 %

9. Kemi kërkuar mendimin e qytetarëve lidhur me atë se me çfarë duhet të karakterizohet Prizreni në aspektin kulturor? Ja dhe përgjigjet e tyre:




Arkitekturën dhe monumentet e vjetra historike: 113 persona apo 25.1 %
 Objektet fetare: 9 persona apo 2.0 %
 Turizmin kulturor: 33 persona apo 7.3 %
 Teatrin: 37 persona apo 8.2 %
 Muzikën Folklorike: 74 persona apo 16.4 %
 Dokufestin: 60 persona apo 13.3 %
 Artizanatit: 2 persona apo 0.4 %
 Lidhjen e Prizrenit: 18 persona apo 4.0 %
 Nuk e di: 104 persona apo 23.1 %

10. A keni dëgjuar për Teatrin ODA nga Prishtina, nëse po çka mendoni për punën e këtij institucioni?




Nuk kam dëgjuar: 159 persona apo 35.3 %
 Po, kam dëgjuar por nuk di shumë për punën e tij: 181 persona apo 40.2 %
 Po, kam dëgjuar dhe aspak nuk më pëlqen puna e tij: 11 persona apo 2.4 %
 Po, kam dëgjuar dhe më pëlqen puna e tij: 74 persona apo 16.4 %
 Po, kam dëgjuar dhe shumë më pëlqen puna e tij: 25 persona apo 5.6 %

12. Sa janë qytetarët të ftuar nga komuna? Këtë informatë jemi munduar ta mbledhim përmes pyetjes drejtuar qytetarëve se sa ju përfshin komuna në çështjet që kanë të bëjnë me zhvillimin e kulturës?




Nuk më përfshin fare: 162 persona apo 36.0 %
 Shumë pak: 171 persona apo 38.0 %
 Mesatarisht: 83 persona apo 18.4 %
 Gati gjithmonë: 27 persona apo 6.0 %
 Gjithmonë: 7 persona apo 1.6 %

11. Kërkuam mendimin e qytetarëve lidhur me kyçjen aktive të komunës në organizimin e jetës kulturore, dhe ja si ishin përgjigjet e tyre:




Aspak e kyçur: 90 persona apo 20.0 %
 Jo sa duhet: 186 persona apo 41.3 %
 Mesatarisht: 125 persona apo 27.8 %
 Mjaft e kyçur: 45 persona apo 10.0 %
 Shkëlqyeshëm: 4 persona apo 0.9 %

13. Sa dini për UEB faqen e Komunës dhe shërbimet të cilat i ofron ajo?




Nuk di për uebfaqen e Prizrenit: 162 persona apo 36 %
 Kam dëgjuar por nuk e kam vizituar: 164 persona apo 36.4 %
 E kam vizituar por nuk di për shërbimet: 83 persona apo 14.2 %
 E kam vizituar dhe jam informuar për shërbimet: 34 persona apo 13.3 %

14. Na interesonin idetë e qytetarëve për zhvillimin e kulturës prandaj edhe i kemi pyetur se çfarë do të bënin ata për të përmirësuar jetën kulturore të Prizrenit. Ja se çfarë mendonin ata:




Më shumë ngjarje dhe të jenë të ndryshme:
 85 persona apo 18.9 %
 Hapje të institucioneve të reja: 41 persona apo 9.1 %
 Restaurimin e monumenteve/institucioneve: 75 persona apo 16.7 %
 Të gjitha ato të përmendura: 244 persona apo 54.2 %
 Asgjë nga të përmendurat: 4 persona apo 0.9 %
 Të tjera: 1 person apo 0.2 %

16. Cila është shkalla me të cilën qytetarët janë të kënaqur me përfshirjen e tyre në organizimin e jetës kulturore të Prizrenit?:




Nuk jam aspak i/e kënaqur: 154 persona apo 34.2 %
 Jam pjesërisht i/e kënaqur: 256 persona apo 56.9 %
 Jam tërësisht i/e kënaqur: 40 persona apo 8.9 %

15. A do të preferonin qytetarët e Prizrenit të vizitojnë ngjarje kulturore në vende apo komuna të tjera?




A preferoni ngjarje jashte komunes
 Po: 369 persona apo 82.0 %
 Jo: 68 persona apo 15.1 %
 Të tjera: 13 persona apo 2.9 %

17. Çfarë mendojnë qytetarët, a është kultura aspekt i rëndësishëm i zhvillimit të Prizrenit?



Jo, ka aspekte më të rëndësishme: 31 persona apo 6.9 %
 Pjesërisht e rëndësishme: 117 persona 26.0 %
 Po, është aspekt shumë i rëndësishëm: 302 persona apo 67.1 %

18. Çka prisni nga Kryetari i Komunës së Prizrenit në lidhje me zhvillimin kulturor të komunës?



- Të zhvilloj kulturën
- Të mbroj me ligj monumentet e vjetra
- Të krijoj kushte për artistët dhe të rinjtë
- Restaurimin e monumenteve
- Të angazhohet më shumë për kulturën
- Asgjë të re

Të zhvilloj kulturën: 131 persona apo 29.1 %

Të mbroj me ligj monumentet e vjetra: 30 persona apo 6.7 %

Të krijoj kushte për artistët dhe të rinjtë: 48 persona apo 10.7%

Restaurimin e monumenteve: 24 persona apo 5.3 %

Të angazhohet më shumë për kulturën: 72 persona apo 16.0 %

Asgjë: 145 persona apo 32.2 %

Pasi që kishte përgjigje nga më të ndryshmet jemi munduar që ato ti klasifikojmë në grupe të cilat i kemi paraqitur më lartë.

Koment: Ato përgjigje të cilat nuk kishin të bënin me kulturën i kemi klasifikuar në "Asgjë", p.sh. Të ndërtoj fabrika, të shtroj rrugët me asfalt, etj.

Përmbledhje e sugjerimeve:

Në sugjerimet e qytetarëve të Prizrenit mbretëronte dëshira për ndërtimin e një Kinemaje të re dhe për renovimin dhe hapjen e teatrit, Në vijim nuk munguan as sugjerimet për bashkëpunimin e komunës me OJQ në sferën e kulturës, përkrahje aktiviteteve kulturore të minoriteteve, përkrahjen e artizanatit, etj.

Si shumë interesante kemi vlerësuar kërkesën që të krijohet strategjia për zhvillimin e turizmit kulturor, krijimin e një Agjencioni "rrefyesi turistik", organizimin e debateve publike për zhvillimin e kulturës si dhe shtrirjen e aktiviteteve kulturore në fshatra.

2. Rezultatet nga Intervistat e orientuara

Intervistat janë kryer me Kryetarin e Komunës së Prizrenit, z. Ramadan Muja dhe Koordinatorin e Sektorit për Kulturë në Komunën e Prizrenit, z. Urim Ukimeri, dhe Znj. Adelina Beqiri, anëtarë e Kuvendit Komunal Prizren. Intervistat përbajnë pyetje në disa tematika por janë të fokusuara në çështjet kulturore. Në vijim ju paraqesim përgjigjet e intervistave të zhvilluara me këta zyrtarë:

INTERVISTË

z. Ramadan Muja

Kryetar i Komunës së Prizrenit

Rreth komunës së Prizrenit.-

- Edhe pse nuk ka regjistrim zyrtar që nga viti 1981 dhe numri i saktë i banorëve nuk dihet, një shifër e cila i referohet një përcaktimi të kohës së UNMIK-ut evidentohen 240.000 banorë në komunën e Prizrenit, në bazë të cilës shifër edhe ndahet buxheti nga niveli qendror, por besohet se vetëm qyteti ka kaq.
- Ka shenja që popullsia po rritet edhe pse nuk është trendi i dikurshëm, por megjithatë ka rritje.
- Ndërtimi i autostradës konsiderohet si potencial i fuqishëm për zhvillim ekonomik i cili mundëson lidhjen e Prizrenit me Adriatikut dhe pjesë tjera të Shqipërisë dhe Maqedonisë.
- Themelimi i Universitetit të Prizrenit çmohet si faktor që do të ndikojë në zhvillimin ekonomik por edhe kulturor, pasi që studentët do të kërkojnë edhe jetën kulturore në qytet.
- Buxhetime i investimeve kapitale po rritet çdo vit, 2 milionë euro më shumë do të investohen në 2011 dhe kjo do të kontribuojë edhe në zhvillimin kulturor.
- Shumë mbetje arkeologjike kanë humbur edhe për shkak të rritjes së ujit në fushën e Vërmicës për shkak të rritjes së prurjes nga liqeni i Fierzës, pastaj edhe me ndërtime të reja është mbuluar lokacioni Vlashnje.
- Ka edhe raste të devijimit të autostradës për të ruajtur mbetje arkeologjike.

Kultura në Prizren.-

- Qyteti i Prizrenit ka numër të madh monumente kulturore si qytet i vjetër rreth 2500 vjetësh, dëshmi për të cilën është Kalaja e qytetit.

- Ruajtja e monumenteve që kanë mbetur në Prizren, pas prishjes së arkitekturës së trashëgimisë kulturore nga ana e pushtetit serb në emër të zhvillimit urbanistik. Shumë ndërtime janë bërë mbi gjurmë të lashtësive.
- Zhvillimi i ekonomisë turistike duke vendosur shenja për orientim kah monumentet kulturore
- Sa i përket aktiviteteve artistike funksion qysh pas Luftës së Dytë Botërore Shoqëria Kulturore Artistike “Agimi”, pastaj shumë klube sportive, data të shënuara si Dita e Pavarësisë, pastaj Lidhja e Prizrenit festohen me shumë aktivitete artistike si ditë shumë të rëndësishme për Prizrenit.
- Gjithashtu mbahet edhe “Zambaku i Prizrenit” si festival tradicional që mbahet në Prizren.
- Në Prizren mbahet edhe “Dokufest” ku mblidhen artistë të shumtë të filmit nga mbarë bota, të cilin e përkrah fuqishëm Komuna. Ky aktivitet ka edhe komponentë ekonomike ku gjatë javës së Dokufestit kontribuohet në ekonominë e Komunës.
- Teatri i Prizrenit ka një histori të shquar dhe është krenari për Komunën, ku përpos trupave tjera amatore qytetarëve iu ofrohen shfaqje teatrore nga ky institucion profesionist.
- Të gjitha aktivitetet përkrahen nga Komuna në bazë të mundësive financiare dhe përkrah zhvillimit ekonomik do të rritet edhe përkrahja për sektorin e kulturës.
- Prioritet i veçantë është zhvillimi i ekonomisë turistike, ku është krijuar edhe drejtori e veçantë dhe me përkrahjen edhe të donatorëve ndërkombëtar ka plane për zhvillimin e turizmit rural, ky tashmë që dy vite organizohet Panairi i Djathit të Prizrenit të cilin e përshkon edhe një aktivitet artistik nga shoqëri folklorike në Shatërvan, të cilat gjithashtu përkrahen nga Komuna.
- Mungesa e infrastrukturës shquhet si problem i madh për zhvillimin kulturor në Komunë.
- Ndërtimi i Art Qendrës me një hapësirë të brendshme prej 3500 m2 është një hapësirë që do të jetë në dispozicion për artin dhe kulturën, do të bëhen përpjekje tjera për ngritjen e ndërtesave tjera me partneritetin publiko-privat që do të jenë në shërbim të artit dhe kulturës edhe në lagje tjera të Komunës.
- Ardha e kuadrove të reja profesioniste në Kulturë çmohet si potencial dhe me perspektivë për zhvillimin kulturor.
- Ruajtja e traditave dhe vlerave folklorike kulturore janë një pasuri e çmueshme që përfaqësojnë një potencial të mirë në komunën e Prizrenit.
- Edhe përkundër së humbjes së shumë artefakteve, megjithatë disa ekspozate të çmueshme kanë shpëtuar dhe janë në fondin e Muzeut Arkeologjik të Prizrenit.
- Pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje nuk është në nivelin e dëshiruar por ekziston mundësia që ata të kyçen përmes shoqërive të ndryshme, si dhe kryetari shpesh është në terren për të dëgjuar nevojat e qytetarëve dhe ata janë të interesuar për zhvillimin kulturor.
- Ekziston potencial i madh i ngjarjeve artistike por edhe trashëgimisë kulturore që josh edhe qytetarë të komunave tjera nga gjithë territori i Kosovës.
- Bashkëpunimi me Ministrinë e Kulturës kryesisht fokusohet në bashkëpunimin rreth trashëgimisë kulturore dhe Institutit për mbrojtjen e monumenteve në Prizren.
- Po bëhen përpjekje që të bartet selia e Ministria e Kulturës në Prizren.

Shoqëria civile. -

- Shoqëria civile është e kyçur në vendimmarrjen e Kuvendit Komunal përmes përfaqësuesve të tyre në debatet publike që i organizon Komuna.
- Gati 23% i investimeve kapitale investohet në minoritete dhe trajtimi i tyre në sektorin kulturor është i barabartë me të tjerët.

Mediat.-

- Eksiton marrëdhënie e mirë me mediat përmes zyrës së marrëdhënieve me publikun dhe në përgjithësi pasqyrohet mirë puna e Komunës nëpër media.
- Puna e Komunës është transparente dhe publiku ka qasje në dokumentet zyrtare të Komunës.

Sektori i Biznesit.-

- Ekzistojnë lehtësira për regjistrimin e bizneseve në Prizren, në bazë të marrëveshjes me Ministrinë e Tregtisë tash nuk ka nevojë të shkohet në Prishtinë për regjistrim të biznesit.
- Shquhet interesimi për zhvillimin e zejtarisë dhe tregtisë si dhe bizneseve të vogla e të mesme.
- Biznesi është stimuluar edhe uljen e taksës së Komunës.

Donatorët ndërkombëtar.-

- Është një marrëdhënie e mirë me donatorë ndërkombëtar dhe shumë investime bëhen nga këta donatorë, pothuajse aq sa investon komuna në investime kapitale gjatë vitit (rreth 14 milionë euro në vitin 2011).
- Kryesisht janë donacione nga qeveri evropiane dhe Komisioni Evropian.

Kryetari Muja

- Jeton në Lagjen Ortakoll,
- Aktiv në politikë prej vitit 2002
- Pëlqen muzikën, ka luajtur në violinë dhe mandolinë, parapëlqen muzikën serioze.

- Viziton me ëndje teatrin.
- Shfleton shtypin ditor dhe interesohet për botimin e librave të rinj.
- Parapëlqen revistat shkencore për historinë dhe arkeologjinë.
- Më së shumti i pëlqejnë librat historik.
- Gjatë vikendeve bën rekreacion në natyrë dhe mesatarisht ec rreth 10-15 km.
- Pi kafe me miq kryesisht në Shatërvan (qendër të qytetit).

Intervistë –

z. Urim Ukimeri

Koordinator i sektorit për kulturë

Rreth komunës së Prizrenit.-

- Numri i qytetarëve të Komunës së Prizrenit ka një shtim të lehtë.
- Ekziston plani strategjik për kulturë.
- Prizrenin e sheh në të ardhmen si qendër e kulturës dhe artit, e cila do të promovoj vlerat e trashëgimisë historike, dhe promovimit të turizmit kulturor.
- Probleme përmendet të jetë sigurimi i vijave të rregullta buxhetore për mbështetjen financiare të projekteve në sferën e kulturës
- Komuna thuhet se ka tendencë të rritjes graduale të buxhetit, afarizëm në suaza të normales të komunitetit biznesor, pozitë të mirë gjeografike dhe resurse humane.
- Mendon se prioritetet e komunës duhet të jenë investimet në infrastrukturë, revitalizimi i degëve të caktuara ekonomike përmes subvencioneve (bujqësi, vreshtari, blegtori), promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore, krijimin e parakushteve për veprimtari ekonomike të bizneseve të vogla dhe të mesme.
- Prizrenin e sheh me potenciale të mëdha dhe përmend resurset natyrore dhe njerëzore, pozitën e mirë gjeografike,
- Mendon se qytetarët nuk janë të përfshirë sa duhet por për këtë nuk e sheh si faktore Komunën.
- Si mjet për përfshirjen e qytetarëve i sheh debatet publike të cilat organizohen me qytetarë.
- Beson se Prizreni ka potenciale njerëzore të mjaftueshme për të arritur vizionin që kanë për zhvillimin e komunës, misionin dhe qëllimet e sajë.

Kultura në Prizren.-

- Mendon se komuna ka ofertë kulturore atraktive për të joshur qytetarë jo vetëm të komunave tjera por edhe të vendeve të regjionit dhe më gjerë dhe më tutje numëron ngjarjet si: Dokufest, Zambaku i Prizrenit, Hasi Jehon, Fluturat, Rock-live, Art fest International, dhe manifestime tjera).
- Tregon se kanë propozuar që Ministria e Kulturës të kalojë me seli në Prizren dhe shton se Komuna ka kapacitete infrastrukturore që të akomodojë Ministrinë e Kulturës në Prizren
- Relativisht të mirë e sheh bashkëpunimin me Ministrin e Kulturës.
- Mendon se kultura është faktor i rëndësishëm i zhvillimit kur është fjala për qytetin e Prizrenit.
- Mendon se komuna si potencial të cilin duhet shfrytëzuar ka trashëgimin kulturore dhe resurset natyrore.
- Pas 15 viteve Prizrenin e sheh me hapësira të gjelbëruara dhe të rregulluara publike, shfrytëzim të energjisë së ripërtërishme, ambient të mbrojtur nga ndotjet, dhe mirëqenie sociale.
- Mendon se për momentin mungon përkrahja më e fuqishme financiare e subjekteve dhe individëve në sferën e kulturës dhe në zhvillimin e infrastrukturës kulturore.
- Krijimin e politikave kulturore lokale dhe përkrahjen e projekteve të mirëfillta kulturore dhe artistike i sheh si Prioritete.

Shoqëria civile. -

- Në Prizren tregon se ekziston bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile.
- Do ti përfshinte në proceset vendim marrëse përfaqësuesit nga format e ndryshme organizative të qytetarëve (këshillat shtëpiake, individët, organizatat e shoqërisë civile) dhe shton se ata tanimë, në disa raste e kanë dëshmuar këtë.
- Për komunën e Prizrenit shprehet se një skenë aktive e shoqërisë civile ekziston, dhe e njëjta përkrahet kohë pas kohe sipas projekteve të prezantuara.

Minoritetet. -

- Për minoritetet tregon se komuna zhvillon politika të përkrahjes dhe promovimit të vlerave të tyre kulturore.
- Ndërsa për fonde na njofton se 22,8% nga subvencionet dhe transferet ndahen për minoritete.
- Propozon se duhet të punohet në integrimin e minoritarëve në jetën kulturore me komunitetin shumicë.
- Mendon se nuk ka tensione në mes të grupeve të ndryshme etnike në komunën e Prizrenit pasi që qyteti i Prizrenit njihet për tolerancë, ndëretnike, dhe ndërfetare, është qytet multi-kulturor.

- Për homoseksualët tregon nuk ka njohuri për këtë kategori jo të zakonshme të qenies njerëzore në Komunën e Prizrenit. Mendon se homoseksualizmi është një lloj degjenerimi patologjik, një fenomen i panatyrshëm, përbuzës madje edhe i urreyer, për mentalitetin e këtij nën qielli.

Mediat.-

- Mendon se mediat nacionale janë të përqendruara kryesisht në qendër, ndërsa komunat periferike prezantohen shumë më pak në to.
- Për bashkëpunimin me mediat lokale tregon se është i ndërsjellë dhe gati i përditshëm. Ofrimi i informatave për ngjarjet kulturore dhe jo vetëm ato, përbëjnë një shtyllë të veçantë në politikën programore dhe edituese të medieve lokale në Prizren. Madje ato janë arbritrat më të mirë të vlerësimit të punës dhe angazhimit tonë.
- Mendon se komuna e Prizrenit është e prezantuar mirë në mediat lokale ndërsa në ato qendrore mbetet për të dëshiruar.
- Për marrëdhënie me publikun tregon se kanë të zhvilluar strategjinë dhe na njofton se ekziston zyra e posaçme për komunikim dhe informim, përkatësisht zyra për marrëdhënie me publikun.

Sektori i Biznesit.-

- Me sektorin e biznesit tregon se është arritur të krijohen marrëdhënie reciproke korrekte dhe deri tani janë zhvilluar bashkëpunime në nivel lokal.
- Disa nga bizneset në raste të ndryshme kanë qenë sponsor të komunës dhe janë realizuar shumë projekte të përbashkëta të cilat tani më mbahen çdo vit.
- Për bashkëpunim me organizata ndërkombëtare përmend: “FPHI” – Fondacioni kanadez për Trashëgimi Historike Ndërkombëtare, “CHWB” – Asociacioni suedez për Trashëgiminë Kulturore pa Kufij, “PSF” – Trashëgimia Pa Kufij, me seli në Paris, Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, dhe subjekte tjera ndërkombëtare.
- Kurse lidhur me grantet nga donatorët e jashtëm për përkrahjen e projekteve përmend Komisionin Evropian, TIKA, FPHI, etj.

Intervistë –

Znj. Adelina Beqiri

Anëtare e Kuvendit Komunal Prizren

Rreth komunës së Prizrenit.-

- Një plan strategjik për zhvillimin e kulturës nuk ekziston apo së paku si i tillë nuk është prezantuar para legjislacionit të komunës. Por ekziston Plani Zhvillimor Lokal brenda së cilës është përfshirë sektori i kulturës, si komponent e rëndësishme e zhvillimit të qytetit.
- Vizioni i sajë për Prizrenin është se do të ndërtohet në rrënjët dhe traditat e tij të lashta për t'u bërë qendër ekonomike për tregti, investime, afarizëm, turizëm e kulturë. Prizreni do të mburret me një qeveri lokale të përgjegjshme dhe të angazhuar, e cila bashkëpunon me qytetarët e saj dhe akterët në krijimin e një mjedisi tërheqës për zhvillimin e aktiviteteve afariste dhe inkurajimin për shfrytëzimin më të mirë të potencialit ekonomik lokal dhe resurseve natyrore dhe njerëzore, posaçërisht në fushën e turizmit dhe bujqësisë, duke i ruajtur vlerat e trashëgimisë kulturore e historike.
- Problemet akute dhe më të mëdha të cilat vijnë nga brenda në komunën e Prizrenit i përmend të jenë: Shkalla e lartë e papunësisë, Ndërtimi ilegal dhe shfrytëzimi i pakontrolluar i resurseve, Koordinim i pamjaftueshëm institucional i aktiviteteve ndërmjet komunitetit të biznesit dhe qeverisë lokale, Shfrytëzimi i pamjaftueshëm i kapaciteteve njerëzore, Mungesa e koordinimit mes akterëve të ndryshëm në nivel lokal dhe rajonal dhe Shërbimet e pamjaftueshme publike.
- Kurse përparësitë dhe rrethanat pozitive në komunën e Prizrenit të cilat vijnë nga brenda sipas sajë janë: Pozita gjeografike strategjike, Burime të mjaftueshme të ujit, infrastruktura e rëndë në gjendje të mirë në krahasim me shumicën e komunave të Kosovës, qytet tërheqës për vizitorë dhe investitorë potencialë (anët historike të pastra, qytet i qetë, kushte klimatike të favorshme), Popullata e arsimuar dhe e trajnuar (falë shkollës së lartë dhe universitetit në Prizren)
- Numër i madh i diasporës që punon në shtetet e huaja/perëndimore
- Trashëgimi kulturore-historike e gjerë, potenciale për zhvillimin dhe zgjerimin e turizmit dhe bizneseve private lidhur me turizmin
- Popullata e re për nga mosha (disponueshmëri me fuqi punëtore jo të shtrenjtë)
- Sipas saj influencat nga jashtë të cilat kanë efekte negative në komunë janë: Jo-stabiliteti politik, Infrastruktura ligjore e pakompletuar që duhet të përkrahë ekonominë e tregut, Konkurrenca jolojale (aplikimi i një regjimi të tatimeve që dekurajon prodhimin vendor), Fusha e padefinuar e kompetencave ndërmjet administratës lokale dhe asaj qendrore. Progresi i limituar drejt përmbushjes së standardeve evropiane dhe mosnjohja e shtetit nga 5 vendet e BE-se
- Prioritetet e komunës së Prizrenit për 4 vitet në vijim janë: Zhvillimi ekonomik, reformimi i arsimit, përmirësimi i infrastrukturës, ofrimi i shërbimeve më të mira shëndetësore, ruajtja e trashëgimisë kulturore e historike dhe fuqizimi i rinisë.
- Mendon se potencialet e komunës së Prizrenit të cilat mund të shfrytëzohen për zhvillimin e komunës janë pasuria me resurse minerale dhe njerëzore dhe përvoja në aktivitete tradicionale në bujqësi, procesim të ushqimit dhe artizanate;

- E konsideron kuvendin komunal si konstruktiv dhe beson se me kthimin e opozitës në punimet e KK, do të shtohet roli konstruktiv i anëtarëve të KK-se.
- Mendon se qytetarët e Prizrenit janë mirë të informuar për aktivitetet e KK dhe shton se janë katër OJQ lokale, që nga afër përcjellin punën e KK-se dhe aktivitetet e saj.
- Mendon se qytetarët janë të përfshirë në proceset vendim-marrëse por jo në masën e dëshirueshme. Pjesa e madhe nuk i shfrytëzon mekanizmat e parapare sipas ligjeve dhe rregulloreve në fuqi për tu kyçur në vendimmarrje. Por shton se komunikimi ekziston përmes kontakteve direkte, debateve publike, mbledhjeve nëpër komunitet, takimi me fokus grupe, etj.
- Për potenciale njerëzore mendon se Prizreni ka mjaftë dhe kjo si rezultat i edukimit të gjeneratave të reja në vendet përëndimore të cilat lehtë mund të kombinohen me përvojën e eksperteve lokal, drejt përmbushjes së objektivave të pushtetit lokal.

Kultura në Prizren.-

- Mendon se komuna me ofertën e saj kulturore në këtë moment ka potencial për të tërhequr vëmendjen e qytetarëve nga komunat tjera dhe përmend shembuj si “Dokufest”, i cili mbledh shumë mysafirë nga të gjitha qytetet e Kosovës. Pastaj “40 Bunar fest”, “takimet e Gjeçovit” në Zym, Zambaku i Prizrenit, Hasi Jehon në Gjonaj, etj.
- Mendon se institucionet në fushën e kulturës duhet të barten në Prizren pasi që ky qytet konsiderohet si kryeqytet kulturor i shqiptarëve, me këtë rast përmendet bartja e Ministrisë së Kulturës në Prizren.
- Pajtohet që në bashkëpunim me Ministrin e Kulturës të krijohet grupi punues i cili do të barte gradualisht këtë ministri në Prizren pasi që deri tani nuk vlerësohet si efikas bashkëpunimi me Ministrin e përmendur.
- Mendon se kultura është segment kyq për zhvillimin e Prizrenit sidomos duhet të shfrytëzohen resurset e turizmit kulturor e natyror të komunës së Prizrenit.
- Prizrenin pas 15 vitesh e sheh me traditë të lashtë, qendër ekonomike për tregti, investime, afarizëm, turizëm e kulturë, me një qeveri lokale të përgjegjshme dhe të angazhuar, e cila bashkëpunon me qytetarët e saj.
- Do të kishte dëshirë të ofronte për qytetarët një sallë funksionale të kinemasë, bibliotekë me kapacitete të mjaftueshme, kalendar të qëndrueshëm të aktiviteteve kulturore (vjetor), etj. prioritetet që duhet të vendosen sa i përket kulturës radhiten: Miratimi i ligjit për mbrojtjen e zonës historike të Prizrenit, kompletimi i Art Qendrës, Ndërtimi/funksionalizimi i një kinemaje dhe restaurimi i objekteve të trashëgimisë kulturore
- Do të ndryshonte qasjen e zyrtarëve të DKRS-së, MKRS-së dhe buxhetin e ndarë, duke bërë që së paku 5% të buxhetit komunal të ndahet për sektorin e kulturës.

Shoqëria civile. -

- Një pjese e konsiderueshme e shoqërisë civile janë të përfshire, ose se paku ka konsulta para aprovimit të vendimeve të caktuara.
- Skena e shoqërisë civile është relativisht aktive. Përkrahja e saj ndërlidhet me lobimin në pushtetin lokal për mbështetjen e aktiviteteve të tyre, por edhe për paraqitjen e propozimeve të tyre pranë organeve komunale.

Minoritetet. -

- Prizreni është qytet multi etnik dhe multi kulturor. Vlen të theksohet se që nga paslufta Drejtoria e Kulturës është udhëhequr nga pjesëtarët e komuniteteve. Në tri mandate nga pjesëtari i komunitetit turk dhe në këtë mandat nga pjesëtari i komunitetit boshnjak.
- Në përgjithësi afër 23 % të buxhetit vjetor komunal të Prizrenit, ndahet për projektet e minoritarëve.
- Qeveria komunale nga fondi për subvencione vazhdimisht ka ndarë mjete për përkrahjen e aktiviteteve të shoqatave minoritare, duke mbështetur edhe pjesëmarrjen e tyre në festivalet jashtë vendit.
- Jeta kulturore e komuniteteve në Prizren është mjaft aktive, ku në këtë mes bëjnë pjese edhe shoqatat rome, të cilat kanë trupe teatror, e shume aktivitete tjera. Brenga e tyre është e përbashkët me atë të komunitetit shumicë, që ndërlidhet me kapacitetet e mjetet e kufizuara për realizimin e aktiviteteve kulturore.
- Tensione nuk ka. Euforia e pasluftës është zëvendësuar me një bashkëpunim të ngushtë.
- Beson se çështja e homoseksualëve është e rregulluar me Kushtetutën e Kosovës, dhe secili qytetar i Kosovës e ka për obligim që t'i bindet aktit më të lartë juridik.

Mediat.-

- Mediat elektroniket janë të përqendruar në kryeqytet, derisa mediet e shtypura kanë më shumë hapësirë për komunat.
- Personalisht është e kyçur në politikë pas përvojës në gazetari, prandaj dhe raportet me mediat lokale janë të afërta, pasi shumica janë edhe miq personal.
- Përfaqësimi i komunës në mediat lokale është në nivel të kënaqshëm.
- Në komunë ekziston Zyra për Informim dhe Marrëdhënie me publikun, e cila harton të gjitha politikat në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi.

3. Rezultatet nga takimet me fokus grupe

Fokus grupet si pjesa e tretë e këtij hulumtimi janë mbajtur në Prizren në ambientet e organizatës "Cultural Heritage Without Borders". Grupi i parë ka qenë grupi i artistëve dhe të gjithë pjesëmarrësit në grup qenë të angazhuar në aktivitete artistike. Ata i përkasin moshave dhe profileve të ndryshme. Ky fokus grup është organizuar nga koordinatori dhe partneri lokal në Prizren OJQ "Ec ma ndryshe".

Fokus grupi ka qenë i fokusuar në pyetjet rreth ofertës kulturore ekzistuese në Prizren, problemet që hasin institucionet, OJQ-të dhe iniciativat e pavarura artistike e kulturore në komunën e Prizrenit, interesin e publikut, marrëdhëniet dhe komunikimi mes akterëve kulturorë, qytetarëve dhe qeverisë lokale.

Grupi tjetër i përbërë nga të rinj e të gjitha komuniteteve që jetojnë në komunën e Prizrenit. Ky fokus grup është organizuar nga koordinatori dhe partneri lokal në Prizren OJQ "Ec ma ndryshe". Fokus grupi ka qenë i fokusuar në pyetjet rreth ofertës kulturore ekzistuese në Prizren, interesin e publikut në përgjithësi dhe rinisë në veçanti në ngjarjet kulturore, marrëdhëniet dhe komunikimi mes qytetarëve dhe qeverisë lokale në fushën e kulturës.

FOKUS GRUPI 1. (Artistët)

Mbajtur në Prizren më 22.10.2010

Ambientet e CHWB.

Nr. Pjesëmarrësve: 8

Gjinia: Meshkuj 8

Mosha: 30-60

Edukimi: Superior (Universitar)

Profesioni: Artistë (3), Operatorë kulturorë, drejtues te OJQ-ve kulturore (5).

Këto janë konkluzat kryesore që ky grup ka nxjerrë:

1. OFERTA KULTURORE NË PRIZREN.

- Teatri i Prizrenit ka pasur funksionim më të mirë në të kaluarën dhe konstatohet që është degraduar në shkallë të madhe oferta e këtij institucioni, këtu shtohet edhe fakti i mungesës së një ndërtese për teatër profesional, përderisa teatri funksionon në Shtëpinë e Kulturës, ndërtesë kjo që përdoret edhe për shumë aktivitete tjera përpos teatrit.

- Gjithashtu edhe aktivitete tjera tradicionale si “Zambaku i Prizrenit”, pastaj veprimtaria e SHA “Agimi” konsiderohen si të degraduara dhe me ofertë shumë të zbehtë për publikun , si në aspektin kuantitativ po ashtu edhe në atë kualitativ duke u cilësuar si ofertë amatore.
- Koncertet muzikore janë tepër të rralla dhe pothuajse nuk mbahet mend koncerti i fundit i mirëfilltë.
- Shumë institucione qëndrojnë të mbyllura për publikun, disa për arsye renovimi të stërzgatur me vite e të tjera për mos pasje të aktiviteteve.
- Mungesa e hapësirave për kinema, sallë koncertale, galeri (duke përjashtuar Hamamin e Prizrenit si hapësire jo adekuate por që përdoret për ekspozim) shquhen si mangësi të mëdha të jetës kulturore.
- Edhe iniciativat e pavarura në rrafshin kulturor hasin në vështirësi të mëdha për financim dhe përkrahje dhe si të tilla mbesin të nënrealizuara, gjegjësisht nuk mund të realizohet ajo që është projektuar.
- Në Prizren funksionon edhe Teatri Turk dhe përkundër fondeve shtesë që ka pasur nga shteti i Turqisë dhe KFORi turk nuk ka pasur një aktivitetet të qëndrueshëm dhe është vetëmjaftuar.
- Roli që do të duhej të kishte Komuna në përkrahje të këtyre aktiviteteve shpesh shndërrohet në pengesë dhe qeveria komunale kritikohet ashpër për mungesë përkrahjeje.
- Si shembuj të mirë përmenden Dokufesti, që shënon një ngjarje tashmë tradicionale me ndikim të madh në qytetin e Prizrenit, vlerësohet Biblioteka e qytetit përkundër mungesës së hapësirës adekuate ka një menaxhim cilësor dhe fond të pasur të librave, mbijetesa e Kolonisë së Artistëve, disa grupeve muzikore cilësohen si veprimtari që e fuqizojnë jetën kulturore në Prizren.
- Publikimi i Gidës së qytetit të Prizrenit ku përfshihet edhe sfera kulturore cilësohet si një publikim i mirë dhe që jep deri diku pasqyrë reale të asaj që ofrohet në Prizren.

2. PROBLEMET NË FUSHËN E KULTURËS.

- Fakti i një buxheti komunal prej afro 25 milion eurosh që ndan për Kulturë, Rini e Sport 100 mijë euro shquhet si problemi bazë që hap kapitullin e problemeve në këtë fushë:
- Mosgatishmëri e institucioneve dhe e Kryetarit të Komunës as për takim e jo më për përkrahje te projekteve, bazuar edhe në përvoja individuale të pjesëmarrësve në fokus grup.
- IkJa e kuadrove në Prishtinë – si pasojë e mungesës së perspektivës për t’u angazhuar në profesionet e tyre.
- Udhëheqja e Drejtorisë së Kulturës nga radhët e minoriteteve si marrëveshje politike që 10 vite me radhe shkakton shumë probleme, ndër të tjera edhe probleme komunikimi për shkak të mos njohjes së gjuhës shqipe dhe angleze.

- Qendra e Artit – projekt që ka filluar nga Komuna si pasojë e presionit të mungesës së hapësirave kulturore, tashmë është ndërprerë, edhe pse është premtuar që do të përfundohet në gusht të vitit 2009. Këtu kritikohet ashpër qasja e qeverisë komunale për mos transparencë për destinimin e këtij objekti, për moskonsultim me akterët e fushës së kulturës dhe ekziston mosbesim i madh për fatin e këtij objekti duke rrezikuar që të shndërrohet në biznes qendër me hapësira të limituara për veprimtari kulturore, ilustruhet qasja jo serioze me faktin që një objekt kapital me investim prej 1.5 milion eurosh ndahen vetëm 2000 euro për pajisje për kinema që fillimisht ka qenë thelbi i kësaj nisme.
- Në përgjithësi vlerësohet si jo i mjaftueshëm niveli i informimit për debate publike nga ana e Komunës në tabela të vogla në qytet ku shumë qytetarë nuk janë të informuar.
- Procesi i decentralizimit ka lënë në varshmëri të komunës shumë institucione kulturore dhe derisa në të kaluarën ligji e ka obliguar Komunën të participojë me 49% të financimit (51% nga niveli qendror), tash Komuna vendos për përkrahje simbolike me shuma shumë të vogla.
- Mosgatishmëri e qeverisë komunale që të funksionalizojë objektet ekzistuese, siç është kinemaja e vjetër që nuk funksionon tash e sa vite, ose objekte tjera që janë jo funksionale e që mund të përdoren për veprimtari artistike e kulturore.

3. NEVOJAT DHE REKOMANDIMET

- Organizimi sindikal – asociacionet
- Shprehet nevoja e domosdoshme për përkrahje shumë më të fuqishme të jetës kulturore në Prizren, përpos përkrahjes financiare, rekomandohen edhe strategji të shndërrimit të hapësirave të pashfrytëzuara për qëllime kulturore duke pasuruar kështu jetën kulturore të qytetarëve me plotësimin e aktiviteteve që nuk janë duke u zhvilluar në komunën e Prizrenit.
- Shprehet fuqishëm nevoja për organizimin e sektorit kulturor për të pasur një zë të përbashkët më të fuqishëm për t'i përfaqësuar interesat e sektorit dhe mbrojtur të drejtën e qytetarëve për jetë më të begatshme kulturore.

FOKUS GRUPI 2. (Rinia)

Mbajtur në Prizren më 22.10.2010,

Ambientet e CHwB

Nr. Pjesëmarrësve: 6

Gjinia: Meshkuj 4; Femra 2

Mosha: 15-18

Profesioni: Nxënës (1), Aktivistë rinorë (5).

Këto janë konkluzat kryesore që ky grup ka nxjerrë:

- Edhe pse shihet si qytet kulturor nga jashtë , derisa në fakt nuk ka shume ngjarje kulturore, përpos Dokufestit që shquhet si ngjarje e madhe kulturore, dhe disa ngjarjeve tjera sporadike.
- Në përgjithësi edhe nuk ka shumë të interesuar në ngjarje kulturore kur ato kohë pas kohe ndodhin.
- Oferta më e madhe edhe do të mund të rriste interesimin e vizitorëve.
- Ngjarjet e rralla kulturore ndikojnë shumë edhe në shprehinë e të qenit aktiv në aktivitete kulturore.
- Aktivitetet artistike duhet të jenë pjesë aktive e jetës shkollore.
- Duke qenë pjesë e organizimit shkollor të rinjtë do të kyçeshin në mënyrë aktive në ngjarjet kulturore dhe kështu do të krijoheshin shprehi të mira të përcjelljes së jetës kulturore.
- Informimi për aktivitetet kulturore është i mangët dhe do të duhej të punohej më shumë në këtë aspekt. Mungon informimi për ngjarjet kulturore jashtë qendrës së qytetit.
- Megjithatë, shpesh edhe përkundër të rinjtë janë të informuar për ndonjë ngjarje kulturore, ata nuk i vizitojnë ato ngjarje.
- Çmimi i biletës për ngjarje kulturore paraqet çështje për rininë, por megjithatë nuk është faktori kryesor, shpesh në ngjarje kulturore pa pagesë të rinjtë nuk shfaqin interesim.
- Temat që trajtohen nëpër prodhimet kulturore shpesh nuk përkasin me interesimin e të rinjve.
- Preferohen tema nga vlerat e kulturës burimore, qytetaria aktive, ruajtja e pasurisë së përbashkët etj.
- Oferta kulturore në fushën e muzeve nuk është edhe shumë e pasur
- Nuk ka shumë informata për Art Qendrën që po ndërtohet në Prizren. Nuk dihet se çka do të ketë saktësisht aty.
- Shprehet interesim më i madh për të pasur kinema në qytet, përpos aktiviteteve tjera.
- Klubet artistike për të rinj shquhen si iniciativa të mira që do të krijonin hapësira adekuate për të mbledhur të rinjtë që do të ushtronin aktivitete artistike dhe aktivitete tjera për rininë.
- Kritikohet edhe mungesa e vetiniciativës së të rinjve për iniciativa kulturore e artistike, përpos mungesës së përkrahjes publike për initiative të tilla

KONKLUDIME NGA HULUMTIMI NË KOMUNËN E PRIZRENIT

Pyetësorët të cilët u plotësuan nga qytetarët e Prizrenit ofruan mjaftë të dhëna për të sjellë përfundime lidhur me preferencat e tyre kulturore, njohuritë e tyre mbi trashëgimin dhe institucionet kulturore, potencialet me të cilat disponojnë, pjesëmarrjen dhe për mendimet e tyre rreth zhvillimit kulturor.

Qytetarët e Prizrenit treguan interesim të lartë për ngjarjet kulturore që zhvillohen në komunën e tyre, ata më së shumti shkojnë në Teatër, Kinema dhe përcjellin koncertet e muzikës folklorike me të cilat është i njohur Prizreni. Kanë njohuri për trashëgimin kulturore e sidomos me monumentet të vjetra historike të cilat e bëjnë këtë qytet joshës jo vetëm për banorët e Kosovës, por edhe më gjerë, prandaj dhe shprehin dëshirën që ato të mbrohen, restaurohen dhe të përdoren si mjet për zhvillimin e Qytetit.

Qytetarët e Prizrenit mendojnë se kanë potenciale në monumente, natyrë por edhe njerëzore për të pasur një zhvillim të hovshëm kulturor, ata mendojnë se duhet të kyçen më shumë në krijimin e politikave kulturore në mënyrë që të kontribuojnë në zhvillimin e qytetit. Pasi që vlerësojnë Kulturën si një aspekt shumë të rëndësishëm për zhvillim qytetarët propozojnë që të ketë më shumë investime në këtë sektorë duke filluar nga ato kapitale siç është ndërtimi i kinemasë, renovimi dhe hapja e Teatrit e deri te krijimi i strategjisë për zhvillimin e turizmit kulturor dhe përfshirjen më të madhe të profesionistëve.

Nga intervistat e orientuara me përfaqësues të strukturave komunale po ashtu kemi arritur të mbledhim informata të cilat jo vetëm se do të na ndihmojnë për të kuptuar gjendjen aktuale por edhe të krijojmë një pasqyrë rreth asaj se ku synon Prizreni të arrij në sferën e kulturës. Kultura nga të gjithë u vlerësua si segment i rëndësishëm i zhvillimit dhe me shembuj konkret u treguan planet zhvillimore.

Ne si analizues të këtyre informatave mund të nxjerrim konkludimin se Prizreni nuk ka strategji kushtuar vetëm zhvillimit të kulturës por ajo është përfshirë si pjesë përbërëse në strategjinë gjenerale të zhvillimit. Potencialet me të cilat disponon Prizreni janë të shumta prandaj strategjia për shfrytëzimin adekuat të tyre është më se e nevojshme. për zhvillimin. Sipas vizionit të atyre që intervistua po ashtu mund të konkludojmë se Prizrenin dhe kulturën e sajë e presin ditë edhe më të mira dhe kjo falë gatishmërisë dhe përkushtimit të strukturave qeverisëse për të realizuar projekte të cilat do të bënin realitet vizionin e tyre. Sidomos mbresëlënëse ishte gatishmëria për të bashkëpunuar me qytetarë dhe grupet e caktuara të interesit sikur që janë artistët dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile.

Nga takimet me fokus grupe u kuptua se Prizreni ka nevojë për një riorganizim të shpejt sepse shumë nga vlerat të cilat më herët ishin tani janë duke u shuar apo degraduar. Kalimi i kompetencave nga niveli qendror në atë lokal ka krijuar një zbrastirë e cila po reflektohet në kualitetin e ngjarjeve kulturore si dhe shumë projekte mbeten pa u realizuar në mungesë të përkrahjes adekuate financiare. Problemet të cilat artistët identifikuan tregojnë se shumë institucione në emër të renovimeve po mbahen të mbyllura për kohë shumë të gjata si për shembull Teatri dhe në të njëjtën kohë kërkuan investime kapitale sidomos në ndërtimin e kinemasë dhe funksionimit të sajë. Në këto

takime u shpreh nevoja për krijimin e asociacioneve të artistëve të cilët do të ndihmonin në zhvillimin e kulturës si dhe kyçjen e të rinjve në ngjarje kulturore.

Prizreni mbetet qendra më e rëndësishme kulturore në Republikën e Kosovës prandaj ajo nuk duhet lënë të bazohet vetëm në mjetet e sajë vetanake, por duhet përkrahje edhe nga niveli qendrorë.

Të gjithë ne të përfshirë në këtë Projekt do ti mbeteshim borxh qytetarëve të Prizrenit nëse propozimet dhe këshillat e tyre nuk i marrim parasysh dhe nuk i inkorporojmë në një strategji e cila me të vërtet do të ndihmonte Prizrenin të zhvillohet në aspektin kulturor në masën të cilën edhe e meriton.
